



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATËVE NGA LISTAT SHUMEMËRORE PËR KËSHILLAT BASHKIAK NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 19.05.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

**OBJEKT:** Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëemërore për këshillat bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

**BAZË LIGJORE:** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

**VËREN**

Partia Kristian Demokrate, pjesëtare e Koalicionit "Aleanca për Shqipërinë Europiane", në përputhje me nenin 5, pika 4, germa "a" të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka depozituar në Komisionin



**Nr . 567 i vendimit**

**Data 19.05.2017 e vendimit**

**Ora 18:00 e vendimit**

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Qendror të Zgjedhjeve formularët e vetëdeklarimit, të kandidatëve për këshillat bashkiak Mirditë, Has, Memaliaj, Libohovë, Përmet, Pogradec, Kukës, Malësi e Madhe dhe Pukë si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", KQZ verifikoi të dhënat në formularët e vetëdeklarimit për secilin kandidat të listës shumemërore. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, rezulton se asnjë prej kandidatëve nuk kanë deklaruar asnjë të dhënë që përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë sipas ligjit nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe kreut V, pika 2, germa "b" dhe pikës 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile nëpërmjet shkresave si dhe nëpërmjet postës elektronike për kandidatët për anëtarë në këshillat bashkiak, që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Në përgjigje të shkresës, zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar në KQZ, verifikim i gjendjes gjyqësore për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak bashkiak Mirditë, Has, Memaliaj, Libohovë, Përmet, Pogradec, Kukës, Malësi e Madhe dhe Pukë, sipas të cilës rezulton:

**VILSON ÇEKAJ** kandidat i regjistruar në listën shumemërore Partia Kristian Demokrate me numër rendor 15, Bashkia Malësi e Madhe. Sipas shkresës nr.3665 prot, dt.16.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1529/1, datë 17.05.2019, rezulton të jetë dënuar me vendimin gjyqësor nr. 77, datë 17.12.2009, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, është deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale e dënon me 5 (pesë) vjet e 4 (katër) muaj. Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë me vendimin gjyqësor nr. 16, datë 24.02.2010 ka vendosur prishjen e vendimit të mësipërm dhe ndryshimin e tij: Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a, 22 i K.Penal dhe në bazë të tyre dënimin e tij me 10 (dhjetë) vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 6 (gjashtë) vjet e 8 (tetë) muaj burgim.

**SHMAJKEJ LLUMAJ** kandidat i regjistruar në listën shumemërore Partia Kristian Demokrate me numër rendor 09, Bashkia Malësi e Madhe. nr.3665 prot, dt.16.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjendjes Gjyqësore nr. v-1529/1, datë 17.05.2019, rezulton të jetë dënuar me vendimin gjyqësor nr. 378, datë 02.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, është deklaruar fajtor për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe nenit 406 të K.Pr.Penale e dënon me 4 (pesë) muaj burgim. Aplikim i nenit 63 të K.Penal ku vihet të kryej një punë me interes publik për 100 orë pune. Z. Shmajkell Llumaj për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

**GEZIM NOKA** kandidat i regjistruar në listën shumemërore Partia Kristian Demokrate me numër rendor 09, Bashkia Kukës. Sipas shkresës nr. 3665 prot, dt.16.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjendjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të



**Nr . 567 i vendimit**

**Data 19.05.2017 e vendimit**

**Ora 18:00 e vendimit**

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1529/1, datë 17.05.2019, me vendimin nr.69, datë 04.05.2005 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës deklarohet fajtor për veprën parashikuar nga neni 181 të K.Penal dhe në bazë të kësaj dispozite e të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 68 000 (gjashtëdhjetë e tetë mijë) lekë gjobë. Z. Gezim Noka për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Në bazë të vendimit nr.237, datë 03.12.2014 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës deklarohet fajtor për veprën penale të "Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike". Në bazë të nenit 137/1 të K.Penal dhe në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 59 të K.penal pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe vihet në provë për 18 muaj. Z. Gezim Noka për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

**GJETO CEKAJ** kandidat i regjistruar në listën shumemërore Partia Kristian Demokrate me numër rendor 01, Bashkia Malësi e Madhe. Sipas shkresës nr. 3665 prot, dt.16.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjëndjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1529/1, datë 17.05.2019, me vendimin nr.793, datë 23.10.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Moskallzim të krimit" e në bazë të nenit 300/1 të K.Penal dënohet me 200 000 (dyqind mijë) lekë gjobë.

**ERMAL (MALI) ELEZAJ** kandidat i regjistruar në listën shumemërore Partia Kristian Demokrate me numër rendor 07, Bashkia Kukës. Sipas shkresës nr. 3665 prot, dt.16.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjëndjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1529/1, datë 17.05.2019, me vendimin nr.(55-2016-1241) 235, datë 14.02.2016 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës e ka deklaruar fajtor për veprën penale të "Moskallzim Krimi" parashikuar nga neni 300 të K.Penal dënuar me 150 000 lekë gjobë. Në aplikim të nenit 406 të K.Pr.Penale dënohet përfundimisht me 100 000 (njëqind mijë) lekë gjobë. Gjykata e Apelit Shkodër me vendimin nr.292, datë 19.03.2018 vendosi lënien në fuqi të vendimit dhe ndryshimin: deklarimin fajtor për veprat penale "Mbajtje pa leje të armëve luftarake" të parashikuar nga neni 273/3 të K.Penal sipas ndryshimit të Gjykatës Kushtetuese.

**LANDI SHKULLAKU** kandidat i regjistruar në listën shumemërore Partia Kristian Demokrate me numër rendor 09, Bashkia Pogradec, Sipas shkresës nr. 3757 prot, dt.17.05.2019 të KQZ-së drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Sektori i Gjëndjes Gjyqësore, në bazë të Vërtetimit të Gjëndjes Gjyqësore nr. v-1568/1, datë 18.05.2019, me vendimin nr. 644, datë 16.09.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec e ka deklaruar fajtor për veprën penale "Vjedhje" parashikuar nga neni 134/1 i K.Penal dhe dënohet me 240 000 lekë gjobë. Z. Landi Shkullaku për këtë vepër penale është rehabilituar sipas nenit 69 të Kodit Penal.

Referuar germës a, të pikës 1 të nenit 2, të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ndalimet për kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit zbatohen ndaj personave për a) kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/c, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278 paragrafin e parë, të pestë e të gjashtë, 278/a, 282/a, **283, 283/a**, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal;



**Nr . 567 i vendimit**

**Data 19.05.2017 e vendimit**

**Ora 18:00 e vendimit**

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

Ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", në nenin 4 të tij parashikon dhe periudhën gjatë të cilës zbatohen dispozitat e këtij ligji për ndalimin, kandidimin, zgjedhjen apo ushtrimin e funksionit, në varësi të llojit të veprës penale të deklaruar.

Sipas nenit 4 të ligjit të sipërcituar .....

4. Për personat që parashikohen në shkronjën "a", të pikës 1, të nenit 2, të këtij ligji, ndalimi për kandidim, zgjedhje apo ushtrim të mandatit zgjat gjatë gjithë jetës.....

Referuar të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga **z. Vilson Çekaj kandidat me numër rendor 15, për anëtar këshilli i Bashkisë Malësi e Madhe**, vërtetimit të gjendjes gjyqësore në lidhje me veprën penale, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal, vendimin nr. 77, datë 17.12.2009, të Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, **z. Vilson Çekaj** për kryerjen e kësaj veprë penale është brenda periudhës së ndalimit për zgjedhjen në funksionin, kandidat për këshilltar i këshillit të bashkisë Malësi e Madhe.

Për sa më sipër duke qene se kushtet për ndalim janë verifikuar para procesit të pranimit të kandidaturave, referuar nenit 10 pika 1, germa "a" të ligjit 138/2015, KQZ duhet të refuzoj kandidaturën e **z. Vilson Çekaj** dhe t'i kërkoj subjektit zgjedhor Parta Kristian Demokrate të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidaturave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, paragrafi i fundit, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstaton se për personat e tjerë të shënuar në listën shumemërore të dhënat e tyre nuk përbëjnë kusht për mosregjistrimin si kandidatit për këshillin e bashkisë Mirditë, Has, Memaliaj, Libohovë, Përmet, Pogradec, Kukës, Malësi e Madhe dhe Pukë, sipas ligjit nr. 138/2015. KQZ gjithashtu ka bërë publikimin e formularëve të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Referuar nenit 33, germa "f" të Kodit Zgjedhor, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor ka kompetencën për regjistrimin e kandidatëve për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, në ato bashki të cilat administrohen nga një KZAZ.

Në këtë rast, KZAZ duhet vazhdojnë procedurat për regjistrimin e listës shumemërore për këshillin e Bashkisë Mirditë, Has, Memaliaj, Libohovë, Përmet, Pogradec, Kukës, Malësi e Madhe dhe Pukë, të Partisë Kristian Demokrate për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Neni 10, pika 1, germa "a" dhe neni 11 i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", neni 5, pika 4, germa "a" i ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu V, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



**Nr . 567 i vendimit**

**Data 19.05.2017 e vendimit**

**Ora 18:00 e vendimit**

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"

## VENDOSI:

1. Të refuzojë kandidaturën e z. Vilson Çekaj për këshillin e bashkisë Malësi e Madhe, Partia Kristian Demokrate.
2. Njoftimin e Partisë Kristian Demokrate të zëvendësojë kandidaturën brenda afatit të parashikuar për dorëzimin e kandidatëve.
3. Njoftimin e KZAZ-ve përkatëse për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e listës shumëmemërore për këshillat bashkiak në bashkitë Mirditë, Has, Memaliaj, Libohovë, Përmet, Pogradec, Kukës, Malësi e Madhe dhe Pukë, të Partisë Kristian Demokrate për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes bashkëlidhur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv.Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI-</b>	<b>Anëtare</b>



**Nr . 567 i vendimit**

**Data 19.05.2017 e vendimit**

**Ora 18:00 e vendimit**

Për verifikimin e deklarimeve në formularin e vetëdeklarimit të kandidatëve nga listat shumëmemërore për Këshillat Bashkiak në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"